



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË *IT*HENTICATE DHE *AI*
DETECTION CAPABILITIES, PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE PËR
DETEKTIMIN E PLAGJIATURËS NË VEPRIMTARINË KËRKIMORE DHE
BOTUESE NË UV DHE PËR PALËT E TRETA.**

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 24, datë 08.05.2018 dhe ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 66, datë 26.06.2025 dhe Vendim të Senatit Akademik Nr. 130, datë 23.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

Neni 1

Kjo rregullore përcakton mënyrën e përdorimit të programeve kompjuterike *iThenticate*, duke përfshirë edhe kapacitetet për detektimin e përmbajtjes së gjeneruar nga inteligjenca artificiale (*AI Detection Capabilities*), në veprimtarinë kërkimore dhe botuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë dhe palët e treta të interesuara. Rektori cakton me vendim personat përgjegjës për operimin teknik të këtyre programeve kompjuterike dhe për realizimin e procesit të kontrollit të plagjiaturës.

I – Përdorimi i programeve kompjuterike për kontrollin dhe detektimin e plagjiaturës në punimet e doktoratës, temave të diplomave, artikujve shkencor, Buletinit Shkencor të UV-së dhe shërbimin ndaj palëve të treta;

Neni 2

Çdo disertacion/temë diplome e punuar, e paraqitur pranë njësisë kryesore përkatës në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë duhet t’i nënshtrohet kontrollit përmes përdorimit të programeve kompjuterike për detektimin e plagjiaturës.

Neni 3

Rezultati i kontrollit të disertacionit të doktoratës përmes përdorimit të programeve kompjuterike për detektimin e plagjiaturës është pjesë e domosdoshme e raportit të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

Neni 4

Kontrolli i disertacionit me përdorimin e programeve kompjuterike për detektimin e plagjiaturës do të realizohet në këtë mënyrë:

- drejtuesi i njësisë kryesore, i cili ka pranuar disertacionin e punuar nga kandidati për doktoratë, brenda një afati prej 5 ditësh, nga dita e pranimit ia dërgon Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë disertacionin në formë elektronike në adresën e postës elektronike rektori@univlora.edu.al, me kërkesën për realizimin e procesit të detektimit për plagjiaturë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- personat e caktuar me vendim të rektorit realizojnë procesin e detektimit për plagjiaturë brenda një afati prej 10 ditësh nga data e pranimit të kërkesës nga njësia kryesore dhe raportin ia dërgojnë rektorit.
- rektori i universitetit ia dërgon rezultatet e kontrollit të disertacionit drejtuesit të njësisë kryesore që ka bërë kërkesën.
- drejtuesi i njësisë kryesore ia dërgon rezultatet e kontrollit të disertacionit Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", së bashku me çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për përpilimin e raportit lidhur me disertacionin e dorëzuar.

II – Përdorimi i programeve kompjuterike për detektimin e plagjiaturës në kuadër të veprimtarisë akademike të Senatit Akademik dhe këshillave shkencorë dhe botues;

Neni 5

Senati dhe këshillat shkencorë dhe botues, në punën e tyre, mund të përdorin programet kompjuterike për detektimin e plagjiaturës. Nëse gjatë shqyrtimit të ndonjë çështjeje nga ana e këshillave shkencorë dhe botues lind nevoja për përdorimin e këtyre programeve, ata i paraqesin Senatit Akademik kërkesën për përdorimin e tyre. Senati Akademik pas shqyrtimit të kërkesës autorizon përdorimin e programeve.

Neni 6

1. Drejtuesit e njësive bazë, redaktorët ekzekutivë të revistave shkencore dhe botimeve UniVlora, apo persona të tjerë të autorizuar i përcjellin Rektorit të Universitetit 'Ismail Qemali', në formë elektronike, materialet origjinale për botim / punimet shkencore / artikujt shkencorë / disertacionet / temat e diplomave dhe çdo produkt tjetër në pronësi intelektuale të UV-së, për t'iu nënshtruar kontrollit të origjinalitetit përmes përdorimit të programeve kompiuterike për detektimin e plagjiaturës. Zëvendësrektori për Marrdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor verifikon pronësinë e UV-së mbi këto materiale.

2. Të drejtën për të kryer kontroll antiplagjiaturë në programet kompiuterike të përdorura nga UV e kanë edhe punime që nuk janë pronësi intelektuale e UV-së, sipas kërkesës në Rektorat nga palë të treta apo personel i Universitetit të Vlorës. Në këtë rast shërbimi ofrohet me pagesë, sipas tarifave të miratuara në BA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

3. Rektori përcjell materialet për kryerjen e kontrollit antiplagjiaturë tek personat e autorizuar me vendim të Rektorit, të cilët realizojnë procedurën e detektimit të plagjiaturës brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune nga data e pranimi të kërkesës dhe raportin e kontrollit ia dorëzojnë Rektorit. Rezultatet e kontrollit iu përcillen strukturave apo palëve të interesuara.

III- Përdorimi i programeve kompjutrike për detektimin e plagjiaturës për çështje të dërguara Bordit të Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim dhe Këshillit të Etikës;

Neni 7

Bordi i Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim, në punën e vet, mund ti përdorë programet kompjuterike për detektimin e plagjiaturës.

Nëse gjatë ndjekjes së procedurës lidhur me ankesë konkrete (kallëzim) të parashtruar Bordit të Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim paraqitet nevoja për përdorimin e këtyr programeve, atëherë Bordi i Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim nxjerr përfundime lidhur me këtë çështje, të cilat ia relaton dhe përcjell në formë shkresore Këshillit të Etikës.

Në përfundim vlerësohet cili punim shkencor, publikim, apo dorëshkrim duhet të kontrollohet përmes përdorimit të programeve për detektimin e plagjiaturës.

Neni 8

Kryetari i Bordit të Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim ia dërgon Këshillit të Etikës punimin shkencor, publikimin apo dorëshkrimin për të cilin bëhet shqyrtimi në bord, me kërkesën që të ushtrohet kontroll përmes programeve për detektimin e plagjiaturës.

Këshilli i Etikës i dërgon Kryetarit të Senatit në formë elektronike punimin/et shkencor, publikimin/et apo çdo dorëshkrim tjetër që ka marrë miratimin nga Këshilli i Etikës për t'iu nënshtruar kontrollit përmes përdorimit të programeve për detektimin e plagjiaturës.

Personat e autorizuar, me vendim të rektorit, realizojnë procedurën e detektimit të plagjiaturës në afat prej 15 ditësh nga data e pranimi të kërkesës dhe raportin ia dorëzojnë Rektorit, i cili ia dërgon Senatit.

Rezultatet e kontrollit i përcillen Këshillit të Etikës dhe Bordit të Mbikëqyrjes së Etikës në Kërkim brenda një afati prej 10 ditësh nga data e pranimi të raportit nga Senati Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE SENATI AKADEMIK

Neni 9

IV - Përdorimi i programeve kompjuterike për kontrollin e plagjiaturës *iThenticate* dhe *AI Detection Capabilities* nga palët e treta.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ofron shërbimin e ekspertizës për kontrollin e plagjiaturës nga programet kompjuterike (*iThenticate*) dhe përmbajtjes së krijuar nga inteligjenca artificiale (*AI Detection*) edhe për individë apo institucione të jashtme (palë të treta), kundrejt tarifave të miratuara nga Senati Akademik.

Palët e treta paraqesin kërkesën zyrtare pranë zyrës së Protokoll-Arkivës në rektorat, e shoqëruar me dokumentin për të cilin kërkohet ekspertiza dhe vërtetimin e pagesës së tarifës përkatëse.

Pas pranimit të kërkesës dhe dokumentit, personeli i autorizuar i UV-së realizon kontrollin përmes platformës përkatëse brenda 10 ditëve pune dhe përgatit raportin teknik për përqindjen e përputhjes, analizën e citimeve, praninë e teknikave mashtruese (*white text, karaktere të zëvendësuar*), si dhe raportin e *AI Detection*.

Raporti i ekspertizës u dorëzohet palëve në formë elektronike me mbishënimin “*Konfidencial*” dhe ruhet për 6 muaj në arkivin elektronik të UV-së.

Të gjitha dokumentet dhe të dhënat trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e autorit.

V – Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik.